



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 39 dhe 40 të Ligjit mbi tokën ndërtimore (“Gazeta zyrtare e Kosovës” nr. 14/80 dhe 42/86), të nenit 3 al. 1 pika b të Rregullorës mbi vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës nr. 2000/45 të dt. 11. gusht 2000 dhe nenit të 19 al. 1 pika “b” të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjen e mbajtur më 03.06.2004 merr

V E N D I M
MBI NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR CAKTIMIN E
LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT-LABORATORIT PËR
KONTROLL TË CILËSISË SË BARËRAVE NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit-laboratorit për kontroll të cilësisë së barërave në Prishtinë nr. 01-353-369 dt. 26.02.2004.

Neni 2

Në nenin 2. al. 1. të Vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit-laboratorit për kontroll të cilësisë së barërave në Prishtinë nr. 01-353-369 dt. 26.02.2004, fjalët dhe numrat “**në sipërfaqe përafërsisht prej 10 ari**” ndryshohen dhe bëhen “**në sipërfaqe përafërsisht prej 30 ari**”.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.NR. 353-369/1 DT. 08.06.2004

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri